



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3181/9 prot.

Datë 30.01.2024

V E N D I M
Nr. 113/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.01.2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-91613-12-19-2023, me objekt: “Blerje Kimikate per nevojat e Ukt.Sh.A”, me fond limit 209,959,375 lekë pa TVSH, me Nr. REF-91621-12-19-2023, me objekt: “Loti 3: “Blerje Poliklorur Alumini 10 ± 0.5 %”, me fond limit 76,560,000 lekë pa TVSH, parashikuar per t’u zhvilluar më datë 22.01.2024 nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujësjiellës Kanalizime Tiranë.

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-91613-12-19-2023, me objekt: “Blerje Kimikate per nevojat e Ukt.Sh.A”, me fond limit 209,959,375 lekë pa TVSH, me Nr. REF-91621-12-19-2023, me objekt: “Loti 3: “Blerje Poliklorur Alumini 10 ± 0.5 %””, me fond limit 76,560,000 lekë pa TVSH, parashikuar per t’u zhvilluar më datë 22.01.2024 nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujësjiellës Kanalizime Tiranë.

Ankimues: Operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK me NIPT M11815028I dhe adresë: Rruga e Kavajës, Buka SH.A, Nr.8240, Njësia Nr.6., Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Sh.A. Ujësjellës Kanalizime Tiranë
Adresa: Rruga e Kavajës, Ndërtesa nr.133,Njësia Administrative 6, Kodi Postar 1027, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”. Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 20.12.2023, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-91613-12-19-2023, me objekt: “Blerje Kimikate per nevojat e Ukt.Sh.A”, me fond limit 209,959,375 lekë pa TVSH, me Nr. REF-91621-12-19-2023, me objekt: “Loti 3: “Blerje Poliklorur Alumini $10\pm 0.5\%$ ”, me fond limit 76,560,000 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 22.01.2024, nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujësjetës Kanalizime Tiranë.

II.2. Në datën 21.12.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si edhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankesa e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, me nr. 3181/2023 prot., datë 22.12.2023 dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3697, datë 21.12.2023, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi e më konkretisht:

“[...] Shtojca 5

2. Treguesit cilësor dhe karakteristikat kimike të kimikateve

Treguesit e cilësisë dhe karakteristikat kimike të produkteve të ofruara nga firmat konkurrese duhet të plotësojnë parametrat e cilësisë dhe sigurisë si më poshtë: (gjeni bashkangjitur Tabela) Specifikimet janë hartuar në përputhje me Standartet Shtetërore Shqiptare përkatëse konkretisht : Acidi Klorhidrik SSH EN 939: 2009, Polikloruri i Aluminit SSH EN 17034: 2018, Hipokloriti i Natriumit S SH EN 901: 2013.

Lidhur me specifikimet teknike kërkojmë që të modifikohet standarti duke u vendosur në përputhje me Standartet Shtetërore Shqiptare të njohura nga Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) dhe Ministria e Shëndetësisë (S SH EN 901:1999, S SH EN 901 2007) dhe të vendosen ato elementë që ISHP analizon (arsyet sepse i gjeni të analizuar në kriterin 2.11). ... Firma furnizuese përpara se të realizojë shkarkimin e kimikateve për çdo ngarkesë të dorëzuar duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

3-Raport Analizën të lëshuar nga Inspektoriati Sanitar Shtetëror, në origjinal. Ne rastin kur transporti do të kryhet me depozita 1000 l atehere duhet që cdo depozite të jetë shoqëruar me flete-analize.

Lidhur me Shtojcën 5 pika 5.3 Raport Analizën të lëshuar nga Inspektoriati Sanitar Shtetëror, në origjinal. Ne rastin kur transporti do të kryhet me depozita 1000 l atehere duhet që cdo depozite të jetë shoqëruar me flete-analize.

Operatori ekonomik gjykon se duke qënë se të gjitha depozitet mbushen nga e njëjta parti malli nuk është e nevojshme të analizohen të gjitha vec e vec duke marrë parasysh se cdo fletë analizë pranë Inspektoriatit Sanitar Shtetëror ka një kosto ekonomike. Ndërkohë gjykojmë që është mëse e mjaftueshme që mostra të merret nga secila depozitë dhe të analizohet e gjitha bashkë, pra më një fletë analize dhe kjo eliminon kostot e panevojshme për të testuar secilën mostër vec e vec!

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

-Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për mallrat e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor. Ne rast se do të paraqitet kjo e fundit duhet të vertetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Përsa i takon këtij kriteri operatori jonë ekonomik furnizohet nga një distributor i autorizuar i cili nuk lidhur drejt për drejt me prodhuesin por me një distributor tjetër të autorizuar i cili është i lidhur drejt për drejt me prodhuesin, për këtë arsye lidhja është e pamundur dhe për

këtë arsye duhet të pranohet vetëm autorizimi i distributorit tonë të autorizuar dhe operatorit tonë ekonomik. Autorizimi jonë tejkalon sasisë e kërkuara nga kjo procedurë prokurimi (gjeni bashkëngjitur).

Për sa më sipër kërkojmë modifikimin e këtij kriteri, duke pranuar ose autorizimin e këtij kriteri, duke pranuar ose autorizimin e prodhuesit ose autorizimin e distributorit të autorizuar.

2.7. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:
a) Të disponojë Certifikatën SSH 45001:2018 e vlefshme mbi "Sistemin për Menaxhimin e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë". (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).

ISO 18001: 2007 i ndryshuar me ISO 45001: 2018, kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi paraqitjen e Certifikatës 45001:2018 ose ekuivalente së saj për një sistem menaxhimi të shëndetit dhe sigurimit në punë, referuar procedurës objekt ankimi gjykon se kjo kërkesë është e ekzagjeruar. Certifikata 45001:2018 ose ekuivalente e saj garanton sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve që marrin pjesë gjatë një procesi prodhimi apo kryerjes së një veprimtarie e cila vë apo mund të vërë në rrezik shëndetin dhe jetën e punonjësve. Në rastin konkret referuar objektit të prokurimit mund të marrin pjesë përveç kompanive prodhuese të cilat e kanë të detyrueshme certifikimin me 45001:2018 edhe kompani të cilat kanë për objekt të veprimtarisë së tyre vetëm tregtimin e produkteve objekt prokurimi. Në këtë kuptim Komisioni gjykon se për shoqëritë të cilat kanë për objekt veprimtarie vetëm tregtimin e produkteve që do të prokurohen nuk kanë domosdoshmërisht detyrimin të pasjises me certifikatën 45001:2018. Kërkesa e autoritetit kontraktor për disponimin nga ana e operatorëve ekonomikë të certifikatës 45001:2018 ose ekuivalente duhet të hiqet nga kriteret për kualifikim. Vendosija e një kriteri të tillë ndikon në uljen e konkurrencës midis operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, gjithashtu nuk është në proporcion me objektin e prokurimit dhe në funksion të realizimit me sukses të tij.

... **2.8.** Në rast se operatori ekonomik ofertues nuk është prodhues operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë vetëdeklarim me anë të së cilës duhet të deklarojë se mallrat janë konform normave SSH EN 901:2013)

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit në sistemin elektronik.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatave ankimit, certifikatën e prodhuesit konform normave, SSH EN 901:2013).

Lidhur me këtë kriter duke theksuar edhe një herë që ne si operator ekonomik kemi lidhje jo me prodhuesin por me një distributor të autorizuar, nuk mund të posedojmë certifikatën e prodhuesit por deklaratën e distributorit që mallrat janë Konform normave SSH EN 901: 2013 (gjeni bashkëngjitur autorizimin konform SSH EN 901:2013).

Për sa më sipër kërkojmë që dorëzimi i këtij dokumenti nga ana jonë mos të jetë kusht për skualifikim.

2.9. Operatori ekonomik ofertues (në rastin kur nuk është prodhues) duhet të paraqesë në sistemin elektronik një vetëdeklarim me anë të së cilit duhet të deklarojë se në momentin e dorëzimit të mallit do të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktor certifikatën nr. Rech të prodhuesit i cili vërteton dhe identifikon se prodhuesi(t) është i rregjistruar dhe i certifikuar

për tregtimin e produkteve kimike për trajtimin e ujit për konsumim njerëzor.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit në sistemin elektronik.

Lidhur me certifikatën nr. Rech kjo e dhënë është e përcaktuar qartësisht në skedën e sigurisë të mallrave objekt prokurimi dhe për këtë arsye dorëzimi i certifikatës nr. Rech më vete e gjykojmë si të panevojshëm dhe të vendosur qëllimisht për të krijuar mundësi për paqartësi dhe mundësi skualifikimi të paarsye të operatorëve ekonomik, të cilët nuk kanë informacionin e nevojshëm për të shpjeguar që nr. Rech gjendet i përcaktuar qartë në skedën e sigurisë të mallit objekt prokurimi e cila porëzohet në momentin e dorëzimit të mallit tek shtojca 5, pika 5.5 (gjeni bashkangjitur skedën e sigurisë faqe 2 (sezione 3) ku sitohet nr i regjistrimit/nr rech: 01-2119531563-43-XXXX, 01-2119458838-20-XXXX)

Për sa më sipër kërkojmë që ky kriter të hiqet pasi gjendet në skedën e sigurisë që do të dorëzohet gjatë dorëzimit të mallit.

2.10. *Në rast se operatori ekonomik është importues atëherë duhet të paraqesë në sistemin elektronik lejen e importit të lëshuar nga Komisioni i Licensave pranë Ministrisë së Shendetësisë për llojet e sasisë e kimikateve të përcaktuara në DST. Në rast se operatori ekonomik është prodhues vendas atëherë duhet të paraqesë në sistemin elektronik leje mjedisore e tipit A të lëshuar nga QKL për të gjitha kimikatet e kërkuara nga AK.*

Në rast se operatori ekonomik është tregtues vendas atëherë operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik kontratë furnizimi me një prodhues vendas shoqëruar me lejen mjedisore e tipit A të lëshuar nga QKL të prodhuesit vendas ose kontratë furnizimi me 1(një) importues të mallrave si dhe lejen e importit të importuesit të lëshuar nga Komisioni i Licensave pranë Ministrisë së Shendetësisë për llojet e sasisë e kimikateve të përcaktuara në DST.

Kuadri ligjor parashikon licencimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitetin e importimit, eksportimit, magazinimit dhe tregtimit me shumicë e pakicë, ndërkohë që pjesëmarrës në procedurën e prokurimit mund të jenë edhe subjekte të tjera të cilat përmbushin kriteret e veçanta të kualifikimit, por nuk përfshihen në kategoritë e mësipërme. Ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit janë ato të transparencës dhe trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. Referuar sa më lart, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e veçantë të kualifikimit, duke e përshtetur atë me dispozitatat ligjore në fuqi me qëllim që edhe nxitjen e pjesëmarrjesse biznesit të vogël dhe rritjes së konkurrencës, duhet të cilësojë një kriter se leja e importit do të bëhet e kërkueshme në rastin kur ofertuesi shfaqet në cilësinë e importuesit të produkteve të mallit objekt prokurimi.

2.11. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik fletën e analizes nga Instituti i Shendetit Publik për analizat si me poshte: Ngjyra dhe Era, Plumbi(Pb), Kadmiumi (Cd), Kromi (Cr), Nikeli(Ni), Densiteti ose Analizimi i metaleve të rënda të kimikateve të behet në një laborator të licensuar (vëndas ose të huaj), Qender Kerkimore (IKV, IFBZ) apo Universitare që ka kapacitete dhe aparatura të analizoje metalet e rënda në produkte të ndryshme, përfshire dhe kimikatet e siperpermendura. (Për të gjithë elementet të cilët nuk kryhen nga Instituti i Shendetit Publik)*

Se pari: "Densiteti" i kerkuar tek flete analiza e Institutit të Shendetit Publik, për mallin objekt prokurimi nuk kryet nga Instituti i Shendetit Publik.

Se dyti: Bashkangjitur gjeni përgjigjet e dy institucioneve të cilët AK ka cituar si laborator vendas (IKV dhe IFBZ) për kryerjen e analizës toksikologjike. Në përgjigjen e tyre drejtuar Operatorit tonë ekonomik, shprehen qartë se ata nuk kryejnë analiza toksikologjike për produktet mall objekt prokurimi. Kërkojme nga AK shkresën ose informacionin mbi të cilin ata janë bazuar për të cituar këto dy insitucione (IKV dhe IFBZ) si laboratorë të licensuar për kryerjen analizave toksikologjike te kërkuara.

A ka AK informacion shkresor që këto 2 insitucione i kryejnë këto analiza? Sepse një AK duhet të ketë informacion të bayuar në shkresa për të përpiluar një kriter të vecantë kualifikimi dhe jo të marrë përsipër të vendosë kritere të pa dokumentuar ose vërtetuar me fakte, sikurse rezulton të ketë vepruar në rastin e këtyre dy institucioneve.

Po kështu operatori jonë ekonomik gjykon se analiza e ISHP është e mjaftueshme për tu kualifikuar në procedura me këto mallra objekt prokurimi për sa kohë që edhe vetë AK në Shtojcën 5, pika 5. Dokumentacioni shoqërues i çdo ngarkese të kimikateve të trajtimit të ujit me të cilën do të furnizohet Impianti Bovillë. 4-Të paktën një herë në tre muaj, analizën e parametrave të sigurisë të analizuar në Institutin e Shëndetit Publik Tiranë, që përmbledhen tek pikat nr 5 – 12 tek Hipokloriti i Natriumit, Nr 5-14 tek Acidi Kloridrik, Nr 6-13 tek Polikloruri i Aluminit sipas mostrave të zgjedhura rastësisht nga komisioni i kolaudit., kërkon analizën e ISHP me vetëm ato parametra që ky institucion analizon.

Në vazhdim të gjykimit tonë se pse analiza e ISHP është e mjaftueshme për një operator ekonomik për t'u kualifikuar lidhet drejtpërdrejt me Ministrinë e Shëndetësisë, institucioni përgjegjës i cili na pajis ne me Autorizim Importi (leje importi, ashtu sic është kërkuar në kriterin Nr 4 të DST, vendosur nga AK. Ky kriter lidhet drejtpërdrejt me analizën toksikologjike të ISHP, në varësi të përgjigjes së kësaj analize një operator ekonomik ka të drejtë për të importuar dhe nxjerrë në treg këto biocide (Hipoklorit Natriumi, Hipoklorit Kalciumi, Karbon Aktiv etj) të cilat shërbejnë për përdorim human, saktësisht për trajtimin e ujit të pijshëm.....?????

2.12. *Një punësim mesatar i të paktën 3(tre) personave, për muajin e fundit të vërtetuar me;*

- *Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqerore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit;*
- *List pagesat e punonjesve sipas formatit që kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per muajin e fundit.*

(Nëse operatori ekonomik oferton per lote te vecanta, nr.i punonjësve duhet ti korrespondojë numrit të punonjësve të kërkuar në lotin që oferton, ose shumes se loteve qe oferton

Kriteri për të pasur tre punonjës për të marrë pjesë në një procedurë, 6 nëse meer pjesë në dy procedura dhe 9 nesë mërr pjesë në tre, është një kriter i cili nuk lidhet ngushte me mallin objekt prokurimi, pasi në rastin e operatorit tonë ekonomik në jemi tregëtues i mallit objekt prokurimi, madje në rastin konkret ne nuk do të bëjmë as transportin e mallit (pasi atë do të na e sigurojë vetë furnitori) dhe as magazinimin e mallit pasi furniotri jonë merr përsipër transportin e mallit në pikat e magazinimit të përcaktuar nga AK sipas grafikut të lëvrimit që do të vendoset nga vetë AK.

Për sa më sipër kriteri që përcakton numrin e punonjësve që duhet të ketë OE është i panevojshem dhe nuk ka asnjë efekt në ecurinë e procedurës së prokurimit në asnjë fazë të saj.

2.13. *Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre të paktën 1 (një) kimist dhe një drejtues mjeti (brenda numrit të kërkuar në pikën 2.12). Për punonjësën "Kimist"*

operatori ekonomik duhet të paraqesë diplomë, dhe kontratë pune (e vlefshme për të paktën periudhën e parashikuar) Kjo kërkesë në rastin e ofertuesve që nuk janë prodhues por janë tregtues të produktit objekt-prokurimi është i ekzagjeruar, pasi nuk është e lidhur ngushtë me fazën e paraqitjes së ofertës, por fazën e zbatimit të kontratës, prandaj autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e këtij kriteri, duke përcaktuar vetëm mundësinë që operatorët ekonomikë ofertues të kenë mundësinë për të disponuar një punonjës me profesionin kimist sipas formës ligjore të parashikuar në legjislacionin përkatës dhe për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës, si dhe duke hequr kërkesën që ky punonjës të figurojë i punësuar në listëpagesën e shoqërisë.

- Për punonjësin "Drejtues mjeti" dokumentat që duhet të paraqes janë: Leje drejtimi për mjete që kryejn transportin e lëndëve të rrezikshme (ADR) (e vlefshme) si dhe të figurojë në listëpagesat e muajit të fundit të shoqërisë. Për rastin kur mjetet dhe makineritë sigurohen nëpërmjet kontratës së qerasë atëherë operatori ekonomik për punonjësin "Drejtues mjeti" duhet të paraqesë kontratë punësimi për vetëdeklarimet mbi punonjësit e kërkuar në DST. (Nëse operatori ekonomik oferton për lote të vecanta, nr.i punonjësve duhet të korrespondojë numrit të punonjësve të kërkuar në lotin që oferton, ose shumës së loteve që oferton) Duke qënë se ky kriter lidhet ngushtë me kriterin 2.14, gjeni arsyetimin tek kriteri 2.14. Kërkojmë modifikimin e këtij kriteri.

2.14 Operatori ekonomik për Loti 1 "Blerje Hipoklorit Natriumi 13-15%", duhet të ketë në pronësi ose me qera 2 mjete (autobot) të autorizuar për transport kimikatesh Gjithashtu për transportin e këtyre kimikateve mund të përdoren depozita 1000 l IBC (intermediate bulk container) të jete të vullosura, të pajisura me certifikatat e testimit dhe certifikatat ADR për secilen depozitë, dhe të miratuar në përputhje me dispozitat ADR sipas ligjit Nr. 118/2012 „PËR TRANSPORTIN E MALLRAVE TË RREZIKSHME“ për arsye se këto kimikate klasifikohen si produkt ADR me kodet si më poshtë

Kodi UN1791, ADR 1791 solution HIPOKLORIT NATRIUMI

Kamioni që transporton kimikatet me këto depozita 1000 l duhet gjithashtu të jete i pajisur me certifikate (ADR) për transport lëndesh të rrezikshme (KIMIKATE).

Nëse operatori ekonomik oferton për më shumë se një lot, duhet të vetëdeklarojë, se disponon mjete transporti për secilin nga kimikatet që do të transportojë, sipas specifikimeve teknike të kërkuara për këtë procedurë prokurimi.

Së pari: Për sa i takon kriterit 2.14 në lidhje me të paturin në pronësi ose me qera të një autoboti ose automjeti, operatori jonë ekonomik nuk ka në pronësi dhe as me qera një autobot ose automjet pasi furnitori jonë na siguron transportin e mallrave objekt prokurimi me autobot ose automjetet e transportuesit të tij dhe ne nuk e kemi të nevojshme të kemi në pronësi ose me qera autobot ose automjet (gjeni bashkelidhur deklaratën doganore në të cilën shihet qartë në pikën 12 Detajet e vlerës dhe pikën 20 Kushtet e lëvrimit, CPT, Tiranë AL që transporti sigurohet nga furnitori, ndërsa në pikën 18 dhe 21 dallohen targat e autobotit. Po kështu furnitori jonë merr përsipër të sjellë mallrat objekt prokurimi sipas vendodhjeve të përcaktuara në Shtojcën 5.

Kriteri 2.14 dhe kriteri 2.13 pika janë kritere të ekzagjeruara të cilat tejkalojnë kompetencat e AK duke marrë përsipër të bëjë rolin e autoriteteve të Qarkullimit Rrugor dhe Transportit Rrugor të cilët kanë tagrin ligjor dhe strukturat përkatëse për të kontrrolluar, inspektuar dhe penalizuar, nëse automjetet ose autobotet qarkullojnë në rrugët e Republikës së Shqipërisë brenda kushteve të ADR ose jo.

Ndërkohë AK duhet të kërkojë vetëm ato të drejta që i lindin nga momenti që malli objekt prokurimi magazinohet në ambjentet e tij, pra nëse malli përmbush specifikat e kërkuara nga AK, dhe jo të marrë përsipër të kryejë kompetenca të insitucioneve të tjera në të cilat AK nuk është palë, pasi kjo është një marrëdhënie dy palëshë mes operatorit ekonomik dhe autoriteteve të qarkullimit dhe transportit rrugor. Thënë kjo detyrimet që ka operatori ekonomik ndaj autoriteteve të qarkullimit rrugor janë përgjegjësi e operatorit ekonomik jo e AK, e cila tejkalon kompetencat e veta. Edhe pse operatori jonë ekonomik importon mallrat objekt prokurimi dhe si rrejdhim automjetet dhe depozitat janë të pajisur me certifikime ADR pasi në të kundërt nuk do të kalonin procedurën e eksportit dhe importit në doganat respektive që realizojnë eksportin dhe importin e këtyre mallrave objekt prokurimi, kjo pasi ligji i ADR është një kusht i vendosur nga vetë Bashkimi Evropian.

Thënë kjo duke qënë se ADR është një detyrim ligjor për transportuesit nuk është e nevojshme që të vendoset si kriter nga AK dhe as të diskutohet për sa kohë certifikimi ADR është kusht ligjor për transportimin e lëndëve të rrezikshme (Kimikate).

Po kështu kriteri 2.13 Për punonjësin "Drejtues mjeti" dokumentat që duhet të paraqes janë: Leje drejtimi për mjete që kryejn transportin e lëndëve të rrezikshme (ADR) (e vlefshme) si dhe te figurojë në listpagesat e muajit të fundit të shoqërisë. Për punonjësin "Drejtues mjeti" dokumentat që duhet të paraqes janë: Leje drejtimi për mjete që kryejn transportin e lëndëve të rrezikshme (ADR) (e vlefshme) si dhe te figurojë në listpagesat e muajit të fundit të shoqërisë., në rastin e operatorit tonë ekonomik drejtuesi i mjetit do të jetë një punonjës i kompanisë ndërkombëtare që do të realizojë transportin e mallit, për këtë arsye kriteri duhet të ndryshohet duke përfshirë vetëm ato raste kur drejtuesi i mjetit është punonjës i OE. Duke qënë se në transportin do të na e sigurojë furnitori jonë, dhe nëse është e nevojshme ne mund t'i'u vemë në dispozicion një deklaratë nga furnitori jonë i cili merr përsipër transportin e mallit në pikat e magazinimit të kërkuara nga AK, thënë kjo ne si OE automatikisht përjashtohemi nga detyrimi për të përmbushjen e kriterit 2.13, 2.14 dhe Shtojca 5 pika 3 Specifikat e automjetit që do të shërbejë për furnizimin e kimikateve.

... Për këto arsye kërkojmë që këto kritere të hiqen ose të modifikohen duke përfshirë edhe situacionin e operatorit tonë ekonomik.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Nëpërmjet shkresës nr. 18366/17 prot., datë 29.12.2023 , protokolluar me tonën me nr. 3181/2 prot., datë 03.01.2024 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5. Referuar shkresës të sipërcituar të autoritetit kontraktor rezulton se, ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” SHPK dhe e ka njoftuar atë se ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës duke pranuar kërkesat si më poshtë:

[...] Së treti, në formularin e ankesës operatori ekonomik ankimues kundërshton vendosjen ose modifikimin e kriterit 2.7 në kushtet e vecatnta të kualifikimit në të cilën është kërkuar:

2.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO te

lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht :

- a) *Të disponojë Çertifikatën S SH 45001:2018 e vlefshme mbi "Sistemin për Menaxhimin e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë". (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marrëveshjes).*

Komisioni i shqyrtimit të ankesave ju bën me dije se pretendimet e operatorit ekonomik qëndrojnë dhe për rrjedhojë pranohet.

Njësia e prokurimit do ju bëjë me dije nëpërmjet hartimit të një shtojce.

Së katërti, AK ka kërkuar në kushtet e vecanta të kualifikimit përkatësisht në pikën 2.9 si më poshtë cituar:

2.9 Operatori ekonomik ofertues (në rastin kur nuk është prodhues) duhet të paraqesë në sistemin elektronik një vetedeklarim me anë të së cilit duhet të deklarojë se në momentin e dorëzimit të mallit do të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktor certifikatën nr. Rech të prodhuesit i cili vërteton dhe identifikon se prodhuesi(t) është i rregjistruar dhe i çertifikuar për tregtimin e produkteve kimike për trajtimin e ujit për konsumim njerëzor.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit në sistemin elektronik.

Në formularin e ankesës operatori ekonomik ankimues kërkon të hiqet kriteri 2.9 në kushtet e vecanta të kualifikimit pasi ky kriter gjendet në skedën e sigurisë që do të dorëzohet gjatë dorëzimit të mallit.

Komisioni i shqyrtimit të ankesave ju bën me dije se pretendimet e operatorit ekonomik qëndrojnë dhe për rrjedhojë pranohet.

Njësia e prokurimit do ju bëjë me dije nëpërmjet hartimit të një shtojce.

II.6. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik konstatohet, se Autoriteti Kontraktor e ka publikuar në sistemin e prokurimit elektronik shtojcën me ndryshimet përkatëse sipas vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave.

II.7. Me shkresën nr.3181/3 prot., datë 08.01.2024 është protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, “Formulari i paraqitjes së argumenteve” nga operatori ekonomik ankimues “Albanian Distribution Chemicals” SHPK, lidhur me ankesën me nr.3181, datë 22.12.2023.

II.8. Me shkresën nr. 3181/4 prot, datë 10.01.2024, me objekt: “Vënie në dijeni”, Komisioni Prokurimit Publik iu drejtua Autoritetit Kontraktor, Operatorit Ekonomik Ankimues dhe Agjencisë së Prokurimit Publik, duke i informuar, se Komisioni Prokurimit Publik referuar nenit 115, pika 5 të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik” dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021, “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, iu bën të ditur të gjitha palëve të mësipërme, se Komisioni Prokurimit Publik ka kërkuar informacion shtesë verifikim nga palë të treta (institucione shtetërore), dhe në referim të dispozitave të sipërcituara afatet për shqyrtimin e ankesës nr. 3181 prot, datë 22.12.2023 do të ndërpriten deri në mbërritjen e informacionit.

II.9. Me shkresën nr. 3181/5 prot, datë 10.01.2024, me objekt: “Kërkesë për informacion”, Komisioni Prokurimit Publik iu drejtua Institutit të Shëndetit Publik, duke kërkuar informacion me përmbajtje si vijon:

Në kuptim e zbatim të nenit 24 pika 1 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij.

Në kuadër të shqyrtimit të një ankese, të paraqitur pranë institucionit tonë, për një procedurë prokurimi, referuar legjislacionit në fuqi, Komisionit të Prokurimit Publik i shfaqet nevoja e një informacioni nga institucioni juaj. Konkretisht:

- *A është S SHEN 17034:2018 Standardi për produktin Poliklorur Alumini 10 ± 0.5 % ? Nëse jo, cili standart përdoret për këtë produkt?*
- *A është S SH EN 901: 2013 Standardi për produktin Hipoklorit Natriumi 13 – 15 %? Nëse jo, cili standart përdoret për këtë produkt?*
- *A është S SH EN 939 : 2009 Standardi për produktin Acid Klorhidrik 30 – 33 % ? Nëse jo, cili standard përdoret për këtë produkt?*
- *Gjithashtu, për një shqyrtim sa më të drejtë të çështjes objekt-ankimi, kërkojmë nga ana juaj të na informoni nëse institucioni juaj kryen analizë toksikologjike për produktet Poliklorur Alumini 10 ± 0.5 %, Hipoklorit Natriumi 13 – 15 %, dhe Acid Klorhidrik 30 – 33 %? Nëse po, për cilët nga elementët e shënuar në tabelat e mëposhtme mundësohet analiza ?*

Polikloruri i Aluminit 10 ± 0.5 %

<i>Nr</i>	<i>Parametrat</i>	<i>Njësia e matjes</i>	<i>Specifikimet</i>
1	Gjendja		Lëng i kthjellët
2	Ngjyra		E verdhë e lehtë
3	Densiteti 20°C	g/ml	1,18 – 1,22
4	Titulli Al_2O_3	% (m/m)	10.00 ± 0.5 %
5	Titulli Al	% (m/m)	5,3
	Basiciteti relativ ne raport molar OH/3Al		≥ 0.65
	Substancattoksike	mg/kg	Limitet ne mg/kg te Al
6	Arsenik (As) max	mg/kg	14
7	Kadmium (Cd) max	mg/kg	3
8	Kromi (Cr) max	mg/kg	30
9	Merkuri (Hg) max	mg/kg	4
10	Nikeli (Ni) max	mg/kg	20
11	Plumbi (Pb) max	mg/kg	40
12	Antimoni (Sb) max	mg/kg	20

13	Selen (Se) max	mg/kg	20
----	----------------	-------	----

Hipokloriti i Natriumit 13 – 15 % (NaOCl)

Nr	Parametrat	Njësia e matjes	Specifikimet
1	Gjendja		Lëng i kthjellët
2	Ngjyra		Ngjyrë e verdhë
3	Densiteti ne 20 ⁰ C	gr/ml	1,13 ÷ 1,28
4	Titulli Cl ₂	% m/m	13 - 15
	Substancat toksike	mg/kg	Limitet ne mg/kg te klorit aktiv
5	Arseniku (As) max	mg/kg	1
6	Cadmium (Cd) max	mg/kg	2,5
7	Kromi (Cr) max	mg/kg	2,5
8	Merkuri (Hg) max	mg/kg	3,5
9	Nikeli (Ni) max	mg/kg	2,5
10	Plumbi (Pb) max	mg/kg	15
11	Antimoni (Sb) max	mg/kg	20
12	Seleni (Se) max	mg/kg	20

Acidi klorhidrik 30 – 33 % (HCl)

Nr	Parametrat	Njësia e matjes	Specifikimet
1	Gjendja		Lëng i kthjellët
2	Ngjyra		E verdhe e lehte
3	Densiteti në 20 ⁰ C	g/ml	1,135÷1,185
4	Titulli HCl	% (m/m)	30 ÷ 33
	Papastërtitë dhe sub. toksike	mg/kg	Limitet ne mg/kg te HCl 100 %(m/m)
5	Përbërje organike te halogjenuara (si Cl)	mg/kg	max 17
6	Hekuri Fe max	mg/kg	170
7	Arsenik As max	mg/kg	3
8	Kadmium (Cd) max	mg/kg	1
9	Krom (Cr) max	mg/kg	3
10	Mercuri (Hg) max	mg/kg	0,5
11	Nikeli (Ni) max	mg/kg	3
12	Plumbi (Pb) max	mg/kg	3
13	Antimoni (Sb) max	mg/kg	1
14	Seleni (Se) max	mg/kg	5

Me qëllim kryerjen e veprimeve procedurale dhe shqyrtimin në themel të pretendimeve të subjektit ankimes, mbështetur dhe në nenet 24, 115 pika 5 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për

prokurimin publik”, si dhe në pikën 2 të nenit 30 të vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766 datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, kërkojmë nga ana juaj të na vini në dispozicion, në një kohë sa më të shpejtë të jetë e mundur, informacionin e sipërcituar, i cili është i rëndësishëm për mbarëvajtjen e punës së Komisionit të Prokurimit Publik.

II.10. Me shkresën nr.49/1 prot., datë 24.01.2024, protokolluar me tonën me shkresën nr. 3181/6 prot, datë 26.01.2024, me objekt: “Kthim - përgjigje për kërkesë për informacion”, Instituti i Shëndetit Publik ka dërguar informacionin me përmbajtjen si më poshtë:

“Në përgjigje të shkresës suaj Nr. 3181/5 Prot, datë 10.01.2024, ku kërkon informacion lidhur me disa standarde për produktet për trajtimin e ujit të pijshëm, përkatësisht për produktet Poliklorur alumini 10+ 0.5%, hipoklorit natriumi 13-15% dhe acid klorhidrik 30-33%, dhe analizat toksikologjike që kryhen për këto produkte në ISHP, ju bëjmë me dije si vijon:

A. Në produktin poliklorur alumini në ISHP analizohen këta tregues: kadmium, krom, plumb, nikel. Për analizimin e këtyre elementëve në produktin Poliklorur Alumini, përdoren metoda analitike të bazuara në Standardin S SH EN 1302 "Kimikate që përdoren për trajtimin e ujrave të destinuara për konsum njerëzor - Koagulantët me bazë alumini - Metodat analitike". Ky standard rekomandohet për analizimin e këtij produkti në S SH EN 883:2006 "Kimikate që përdoren për trajtimin e ujrave të destinuara për konsum njerëzor - Polihidroksikloruri i aluminit dhe sulfat polihidroksikloruri i aluminit" si dhe gjithë substancat me emërtesë sinonime me to (Poliklorur alumini, PAC, PACI, klorur bazik alumini, BAC).

Në produktin Hipoklorit Natriumi në ISHP analizohen këta tregues: klor aktiv (titulli Cl₂), kadmium, krom, nikel, plumb. Për analizimin e këtyre treguesve, përdoren metoda analitike të bazuara në Standardin SSH EN 901: 2007 "Kimikate që përdoren për trajtimin e ujërave të destinuara për konsum njerëzor Hipokloriti i natriumit", i cili përshkruan edhe metodat analitike që duhet të përdoren për analizimin e këtij produkti.

Në produktin Acid Klorhidrik në ISHP analizohen këta tregues: hekur, kadmium, krom, nikel, plumb. Për analizimin e këtyre elementëve përdoren metoda analitike të bazuara në Standardin SSH EN 939: 1999 "Kimikate që përdoren për trajtimin e ujrave të destinuara për konsum njerëzor - Acidi Klorhidrik" i cili përshkruan edhe metodat analitike që duhet të përdoren për analizimin e këtij produkti.

B. Për vlerësimin e produktit Poliklorur Alumini 10 ± 0.5% përdoret S SH EN 883:2006 "Kimikate që përdoren për trajtimin e ujrave të destinuara për konsum njerëzor Polihidroksikloruri i aluminit dhe sulfat polihidroksikloruri i aluminit"

Për vlerësimin e produktit Hipoklorit Natriumi 13-15% përdoret Standardi SSH EN 901: 2007 "Kimikate që përdoren për trajtimin e ujrave të destinuara për konsum njerëzor - Hipokloriti i natriumit".

Për vlerësimin e produktit Acid Klorhidrik 30-33% përdoret Standardi SSH EN 939: 1999 "Kimikate që përdoren për trajtimin e ujrave të destinuara për konsum njerëzor- Acidi

Klorhidrik".

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit për modifikimin e dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar shkresës të autoritetit kontraktor nr. 18366/17 prot., datë 29.12.2023, protokolluar me tonën me nr. 3181/2 prot., datë 03.01.2024, rezulton, se ky i fundit ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, duke pranuar kërkesat si me poshtë:

[...] Së treti, në formularin e ankesës operatori ekonomik ankimues kundërshton vendosjen ose modifikimin e kriterit 2.7 në kushtet e vecatnta të kualifikimit në të cilën është kërkuar:

2.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht :

b) Të disponojë Certifikatën S SH 45001:2018 e vlefshme mbi "Sistemin për Menaxhimin e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë". (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marrëveshjes).

Komisioni i shqyrtimit të ankesave ju bën me dije se pretendimet e operatorit ekonomik qëndrojnë dhe për rrjedhojë pranohet.

Njësia e prokurimit do ju bëjë me dije nëpërmjet hartimit të një shtojce.

Së katërti, AK ka kërkuar në kushtet e vecanta të kualifikimit përkatësisht në pikën 2.9 si më poshtë cituar:

2.9 Operatori ekonomik ofertues (ne rastin kur nuk është prodhues) duhet të paraqesë në sistemin elektronik një vetedeklarim me anë të së cilit duhet të deklarojë se në momentin e dorëzimit të mallit do të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktor certifikatën nr. Rech të prodhuesit i cili vërteton dhe identifikon se prodhuesi(t) është i rregjistruar dhe i certifikuar për tregtimin e produkteve kimike për trajtimin e ujit për konsumim njerëzor.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për verifikimin e vetedeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit në sistemin elektronik.

Në formularin e ankesës operatori ekonomik ankimues kërkon të hiqet kriteri 2.9 në kushtet e vecatnta të kualifikimit pasi ky kriter gjendet në skedën e sigurisë që do të dorëzohet gjatë dorëzimit të mallit.

Komisioni i shqyrtimit të ankesave ju bën me dije se pretendimet e operatorit ekonomik qëndrojnë dhe për rrjedhojë pranohet.

Njësia e prokurimit do ju bëjë me dije nëpërmjet hartimit të një shtojce.

III.1.2. Neni 30 i LPP-së, parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se : “1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

III.1.4. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik konstatohet, se Autoriteti Kontraktor e ka publikuar në sistemin e prokurimit elektronik shtojcën me ndryshimet përkatëse sipas vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, për të cilën nga ana e operatorit ekonomik ankimues nuk ka patur ankesë.

Për këtë arsye, KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me këtë pjesë të pranuar nga autoriteti kontraktor për ankesën me nr. 3181 prot., datë 21.12.2023 të operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” SHPK, se [...] Shtojca 5

2. Treguesit cilësor dhe karakteristikat kimike të kimikateve

Treguesit e cilësisë dhe karakteristikat kimike të produkteve të ofruara nga firmat konkurrese duhet të plotësojnë parametrat e cilësisë dhe sigurisë si më poshtë: (gjeni bashkengjitur Tabelen) Specifikimet janë hartuar në përputhje me Standardet Shtetërore Shqiptare përkatëse konkretisht : Acidi Klorhidrik SSH EN 939: 2009, Polikloruri i Aluminit SSH EN 17034: 2018, Hipokloriti i Natriumit S SH EN 901: 2013.

Lidhur me specifikimet teknike kërkojmë që të modifikohet standarti duke u vendosur në përputhje me Standartet Shtetërore Shqiptare të njohura nga Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) dhe Ministria e Shëndetësisë (S SH EN 901:1999, S SH EN 901 2007) dhe të vendosen ato elementë që ISHP analizon (arsyet sepse i gjeni të analizuara në kriterin 2.11).[...]

Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1.Në dokumentet e tenderit, shtojcën 5, “Formulari i specifikimeve teknike”, autoriteti ka parashikuar si vijon:

Shtojca 5.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

1. Emërtimi, destinacioni i përdorimit dhe sasia

Proçesi teknologjik i trajtimit të ujit në Impiantin Bovillë realizohet me përdorimin e Hipokloritit të Natriumit 13 – 15 % i cili shërben si oksidues dhe disinfektues, Poliklorurit të Aluminit 10.00 ± 0.5 % si koagulant – flokulant dhe Acidit Klorhidrik 30 – 33 % që përdoret për korrigjimin e pH. Duke u bazuar në llogaritjet e dozimeve të kimikateve për të njëjtat periudha parardhëse dhe në funksion të prurjeve të ujit të planifikuar,rezulton se per nje periudhe 12 mujore nga momenti i nenshkrimit te mareveshjes kuader nevojiten sasitë e mëposhtme të kimikateve të trajtimit të ujit.

Nr	Emërtimi i Kimikatit	Sasia në Kg
1	Hipoklorit Natriumi 13 – 15 %	1,350,000
2	Poliklorur Alumini 10 ± 0.5 %	1000.000
3	Acid Klorhidrik 30 – 33 %	1000.000

2.Treguesit cilësor dhe karakteristikat kimike të kimikateve

Treguesit e cilësisë dhe karakteristikat kimike të produkteve të ofruara nga firmat konkuruese duhet të plotësojnë parametrat e cilësisë dhe sigurisë si më poshtë :

HipokloritiiNatriumit (NaOCl)

<i>Nr</i>	<i>Parametrat</i>	<i>Njësia e matjes</i>	<i>Specifikimet</i>
1	Gjendja		Lëngikthjellët
2	Ngjyra		Ngjyrë e verdhë
3	Densiteti ne 20 ⁰ C	gr/ml	1,13 ÷ 1,28
4	Titulli Cl ₂	% m/m	13 - 15
	Substancat toksike	mg/kg	Limitet ne mg/kg te klorit aktiv
5	Arseniku (As) max	mg/kg	1
6	Cadmium (Cd) max	mg/kg	2,5
7	Kromi (Cr) max	mg/kg	2,5
8	Merkuri (Hg) max	mg/kg	3,5
9	Nikeli (Ni) max	mg/kg	2,5
10	Plumbi (Pb) max	mg/kg	15
11	Antimoni (Sb) max	mg/kg	20
12	Seleni (Se) max	mg/kg	20

Acidi klorhidrik (HCl)

<i>Nr</i>	<i>Parametrat</i>	<i>Njësia e matjes</i>	<i>Specifikimet</i>
1	Gjendja		Lëngikthjellët
2	Ngjyra		E verdhe e lehte
3	Densiteti në 20 ⁰ C	g/ml	1,135÷1,185
4	Titulli HCl	% (m/m)	30 ÷ 33
	Papastërtitë dhe sub. toksike	mg/kg	Limitet ne mg/kg te HCl 100 %(m/m)
5	Përbërje organike te halogjenuara (si Cl)	mg/kg	max 17
6	Hekuri Fe max	mg/kg	170
7	Arsenik As max	mg/kg	3
8	Kadmium (Cd) max	mg/kg	1
9	Krom (Cr) max	mg/kg	3
10	Mercuri (Hg) max	mg/kg	0,5
11	Nikeli (Ni) max	mg/kg	3
12	Plumbi (Pb) max	mg/kg	3
13	Antimoni (Sb) max	mg/kg	1
14	Seleni (Se) max	mg/kg	5

PolikloruriiAluminit

<i>Nr</i>	<i>Parametrat</i>	<i>Njësia e matjes</i>	<i>Specifikimet</i>
1	Gjendja		Lëngikthjellët
2	Ngjyra		E verdhë e lehtë
3	Densiteti 20 ⁰ C	g/ml	1,18 – 1,22
4	Titulli Al ₂ O ₃	% (m/m)	10.00 ± 0.5 %
5	Titulli Al	% (m/m)	5,3
	Basiciteti relativ ne raport molar OH/3Al		≥0.65
	Substancatoksike	mg/kg	Limitet ne mg/kg te Al
6	Arsenik (As) max	mg/kg	14
7	Kadmium (Cd) max	mg/kg	3
8	Kromi (Cr) max	mg/kg	30
9	Merkuri (Hg) max	mg/kg	4
10	Nikeli (Ni) max	mg/kg	20
11	Plumbi (Pb) max	mg/kg	40
12	Antimoni (Sb) max	mg/kg	20
13	Selen (Se) max	mg/kg	20

Specifikimet janë hartuar në përputhje me Standartet Shtetërore Shqiptare përkatëse konkretisht : Acidi Klorhidrik S SH EN 939 : 2009, Polikloruri i Aluminit S SH EN 17034: 2018, Hipokloriti i Natriumit S SH EN 901: 2013.

2. Specifikat e automjetit që do të shërbejë për furnizimin e kimikateve

Furnizimi me kimikate do të kryhet me mjete tip bot të çertifikuara për transportin e lëndëve të rrezikshme sipas standartit të BE. Çisternat e destinuara për transportin e kimikateve duhet të jenë të përshtatshme për të mbajtur prodhim të destinuar për trajtimin e ujit të pijshëm. Ato nuk duhet të kenë transportuar më parë substanca të dëmshme ose të konsideruara si të tilla për ndotjen e ngarkesës së kimikatit. Për furnizimin e Impiantit të Bovillës me Hipoklorit Natriumi, Acid Klorhidrik dhe Poliklorur Alumini, mjetet tip bot duhet të jenë të përshtatshme për secilin nga kimikatet dhe të kenë kapacitet mbajtës nga 22.000-26.000 kg. Për furnizimin e Depove të ujit me Hipoklorit Natriumi, mjeti tip bot duhet të ketë kapacitet mbajtës 10.000-15.000 kg.

Gjithashtu për transportin e ketyre kimikateve mund të perdoren depozita 1000 l IBC (intermediate bulk container) të jenë të vulosura, të pajisura me certifikatat e testimit dhe certifikatat ADR për secilen depozitë, dhe të miratura në përputhje me dispozitat ADR sipas ligjit Nr. 118/2012 „PER TRANSPORTIN E MALLRAVE TË RREZIKSHME“ për arsye se këto kimikate klasifikohen si produkt ADR me kodet si më poshtë

Kodi UN1791, ADR 1791 solution HIPOKLORIT NATRIUMI

Kodi UN1789, ADR 1789 solucion ACID KLOORHIDRIK

Kodi ADR 3264 solucion POLIKLORUR ALUMINI

Kamioni qe transporton kimikatet me keto depozita 1000 l duhet gjithashtu te jete i pajisur me certifikate (ADR) per transport lendesh te rrezikshme (KIMIKATE).

3. Grafiku i furnizimit, dhe oraret e dorëzimit të ngarkesave

Dërgimet e ngarkesave do të bëhen në bazë të një programi, maksimumi mujor, që Drejtori i Sh.A. Ujësjiellës Kanalizimeve Tiranë do t'ja parashtrojë firmës kontraktuese me shkresë ose me fax të paktën 8 ditë më parë duke përjashtuar rastet e veçanta e të pa parashikueshme kur periudha e mësipërme mund të ulet deri në 4 ditë dhe lajmërimi mund të bëhet edhe me telefon. Kërkesa mujore për kimikate do të bëhet në sasi të dhe datat që do të jetë e nevojshme, kjo do të thotë se ka mundësi që sasi të mujore dhe datat e furnizimit me kimikatet e kërkuara të jetë pak te ndryshme ose të ndryshme krahasuar me grafikun e bashkëlidhur i cili është paraprak dhe orientues.

Dorëzimi i ngarkesave në Impiantin Bovillë duhet të bëhet nga e hëna deri të premte, nga ora 8⁰⁰ deri në orën 15⁰⁰.

4. Kontrolli i cilësisë dhe sasisë e ngarkesave të kimikateve

Në ditën e dorëzimit të ngarkesës, do të merren nga ngarkesa me përzgjedhje të paktën 5 kampione të cilat do të futen në enë të përshtatshme, të vulosen dhe firmosen nga marrësi dhe transportuesi, dhe nga të cilat një do të dorëzohet nëpërmjet autotransportuesit firmës furnizuese dhe katër laboratorit fiziko - kimik të Impiantit Bovillë për analiza e verifikime ;

Njëra nga katër kampionet do të ruhet për kontrollin e analizës përfundimtare në rast kundërshtish nga ana e furnitorit. Në një situatë të tillë të dy palet do të ndjekin bashkarisht kontrollin e analizave pranë laboratorit të Ujësjiellës mbi kampionin e katërt të vulosur si dhe mbi atë të firmës furnizuese në qoftë se mbi të nuk është vënë dorë, e ti nënshtrohen marrëveshjes së arsyeshme.

Firma furnizuese që nga momenti kur në mënyrë të verbalizuar është lajmëruar për faktin e mospërputhjes së cilësisë së ngarkesës me specifikimet teknike në përputhje me të cilat ka fituar garën, ka 10 ditë kohë për të prezantuar kundërshtitë e veta, në të kundërt e humb këtë të drejtë.

Në se firma furnizuese e prezanton kundërshtinë e saj në lidhje me rezultatin ose kontrollet e kryera nga laboratorit kimik i Impiantit Bovillë brenda 10 ditëve të marrjes së njoftimit verbal për mos përputhjen e ngarkesës, ajo ka një hapësirë kohore prej 20 ditësh nga dita

e komunikimit verbal për mos përputhjen e ngarkesës, për të bërë analizat në laboratorin e Ujësjetës

Vlen për t'u përmendur që për rastin e kimikateve Poliklorur Alumini përveç analizimit nga në laboratorin e Impiantit Boville duhet parë edhe efektshmëria në sistem (Flokulator) gjatë procesit teknologjik. Nëse gjatë procesit të flokulimit koagulimi kemi probleme me dekantimin e floqeve të krijuara nga procesi atëherë na lind e drejta që të kërkojmë bashkë me furnizuesin eliminimin në maksimum të këtyre problemeve.

Për kontrollin e sasisë do të përdoret një peshorë automjetesh e cila duhet patjetër të jetë e certifikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Meteorologjisë dhe Kalibrimit dhe që bien dakort të dyja palët

5. Dokumentacioni shoqëruar i çdo ngarkese të kimikateve të trajtimit të ujit me të cilën do të furnizohet Impianti Bovillë.

Firma furnizuese përpara se të realizojë shkarkimin e kimikateve për çdo ngarkesë të dorëzuar duhet

të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm

1-Çertifikatën e origjinës ku jepet origjina e produktit në origjinal.

2-Fletë -analiza e prodhuesit për sasinë e kimikateve të ofruar, në origjinal.

3-Raport Analizën të lëshuar nga Inspektoriati Sanitar Shtetëror , në origjinal. Në rastin kur transporti do të kryhet me depozitë 1000 l atëherë duhet që çdo depozitë të jetë shoqëruar me fletë-analizë.

4-Të paktën një herë në tre muaj, analizën e parametrave të sigurisë të analizuar në Institutin e Shëndetit Publik Tiranë, që përmbledhen tek pikat nr 5 – 12 tek Hipokloriti i Natriumit, Nr 5 – 14 tek Acidi Kloridrik, Nr 6 – 13 tek Polikloruri i Aluminit sipas mostrave të zgjedhura rastësisht nga komisioni i kolaudimit.

5-Për secilin kimikat të furnizuar duhet të paraqitet për ngarkesat e para përkatësisht: Acid Kloridrik, Hipoklorit Natriumi dhe Poliklorur Alumini skedat e sigurisë në origjinal.

6-Duhet të paraqitet që me ngarkesën e parë të produktit të furnizuar Leja e Importit të lëshuar nga Komisioni i Licensave pranë Ministrisë së Shëndetësisë për llojet e sasisë e kimikateve të përcaktuara në pikën 1, e noterizuar.

7-Përkthimi në shqip i noterizuar i gjithë dokumentacionit në gjuhë të huaj që shoqëron ngarkesën.

5. Për shpenzimet

Të gjitha shpenzimet duke përfshirë ato të peshimit, të transportit dhe shkarkimit të kimikateve në Impiantin e Trajtimit të Ujit Bovillë si dhe të analizave që do të bëhen

përkatësisht për çdo ngarkesë dhe parti malli pranë Inspektoriatit Sanitar Shtetëror dhe Institutit të Shëndetit Publik do të jenë në ngarkim të firmës fituese.

Specifikimi i Materialeve:

Në të gjitha rastet kur përmendet certifikatë, markë, emër i vecantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

III.2.2. Me shkresën nr.49/1 prot., datë 24.01.2024, protokolluar me tonën me nr. 3181/6 prot, datë 26.01.2024 me objekt: “Kthim - përgjigje për kërkesë për informacion”, Instituti i Shëndetit Publik ka dërguar informacionin me përmbajtjen si më poshtë:

Në përgjigje të shkresës suaj Nr. 3181/5 Prot, datë 10.01.2024, ku kërkon informacion lidhur me disa standarde për produktet për trajtimin e ujit të pijshëm, përkatësisht për produktet Poliklorur alumini 10+ 0.5%, hipoklorit natriumi 13-15% dhe acid klorhidrik 30-33%, dhe analizat toksikologjike që kryhen për këto produkte në ISHP, ju bëjmë me dije si vijon: [...] B. Për vlerësimin e produktit Poliklorur Alumini $10 \pm 0.5\%$ përdoret S SH EN 883:2006 "Kimikate që përdoren për trajtimin e ujrave të destinuara për konsum njerëzor Polihidroksikloruri i aluminit dhe sulfat polihidroksikloruri i aluminit"

Për vlerësimin e produktit Hipoklorit Natriumi 13-15% përdoret Standardi SSH EN 901: 2007 "Kimikate që përdoren për trajtimin e ujrave të destinuara për konsum njerëzor - Hipokloriti i natriumit".

Për vlerësimin e produktit Acid Klorhidrik 30-33% përdoret Standardi SSH EN 939: 1999 "Kimikate që përdoren për trajtimin e ujrave të destinuara për konsum njerëzor Klorhidrik". Acidi

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

III.2.3. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se: “1.Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”

III.2.4. Në nenin 14 “Përgjegjësitë e ISHP-së” të ligjit 10138 datë 11.05.2009 “Për shëndetin publik”, parashikohet shprehimisht se : Instituti i Shëndetit Publik është përgjegjës për: 1. Informimin, këshillimin dhe mbështetjen e Ministrisë së Shëndetësisë në hartimin e politikave dhe të strategjive në fushën e shëndetit publik. 2. Sigurimin e ekspertizave. 3. Realizimin e studimeve të pavarura dhe prodhimin e informacioneve, bazuar në fakte. 4. Pjesëmarrjen në formimin e burimeve njerëzore në shëndet publik.

Ndërsa në nenin 15 “Funksionet” të ligjit 10138 datë 11.05.2009 “Për shëndetin publik”, parashikohet shprehimisht se: Instituti i Shëndetit Publik kryen këto funksione: a) mbikëqyrjen epidemiologjike të sëmundjeve infektive dhe joinfektive; b) menaxhimin e regjistrave kombëtarë; c) kërkimin shkencor në shëndetin publik; ç) ndjekjen e të rejave shëndetësore ndërkombëtare, përfshirë sistemet dhe praktikat; d) trajnimin dhe edukimin universitar në

shëndetin publik; dh) është qendër reference në shëndetin publik; e) informimin e popullatës rreth çështjeve të shëndetit publik.

III.2.5. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së *lex specialis*, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor, edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrin operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtarë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi, që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm.

KPP gjykon, se parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjitha procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin, se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP gjykon, ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën. Metoda e dytë mbështetet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve. Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionale sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të

nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt- kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë.

Gjithashtu referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 “Për prokurimin publik” KE, parashikohet se: *“Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojcës VII do të përcaktohet në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim”*. Ndërsa, në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: *“specifikim teknik”* nënkupton njërën nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modeli për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit;

Në vendimin e GJED Çështja C-368/10 “Komisioni European vs. Mbretëria e Holandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: *“Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”*

III.2.6. KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces.

III.2.7. Referuar legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e specifikimeve teknike ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për sigurimin e produktit sa më cilësor me qëllim realizmin me sukses të kontratës dhe përmbushjen e nevojave. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton specifikimet teknike të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në rastin konkret, KPP vëren se operatori ekonomik kërkon ndryshimin e standardit të Polikloruri i Aluminit nga S SH EN 17034: 2018 i përcaktuar në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, duke u vendosur në përputhje me Standardet Shtetërore Shqiptare të njohura nga Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) dhe Ministria e Shëndetësisë.

Marrë shkas nga ankesa e operatorit ekonomik ankimes “Albania Distribution Chemical” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua me shkresë Institutit të Shëndetit

Publik, si institucion përgjegjës për shëndetin publik dhe njëkohësisht institucion përgjegjës për kryerjen e analizave toksikologjike. Instituti i Shëndetit Publik në përgjigje të kërkesës së KPP lidhur me standardin që përdoret për këtë produkt ka informuar se Për vlerësimin e produktit Poliklorur Alumini $10 \pm 0.5\%$ përdoret S SH EN 883:2006.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë shtojcën 5, sa i përket standardit për Poliklorur Alumini $10 \pm 0.5\%$, sipas kthim - përgjigjes së Institutit të Shëndetit Publik.

Gjithashtu KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë/unifikojë kudo në dokumentet e tenderit standardin për Poliklorur Alumini $10 \pm 0.5\%$, sipas kthim - përgjigjes së Institutit të Shëndetit Publik

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” SHPK për shtojcën 5, *Lidhur me Shtojcën 5 pika 5.3 Raport - Analizën të lëshuar nga Inspektoriati Sanitar Shtetëror, në origjinal. Ne rastin kur transporti do të kryhet me depozita 1000 l atehere duhet që cdo depozitë të jetë shoqëruar me flete-analize.*

Operatori ekonomik gjykon, se duke qenë se të gjitha depozitet mbushen nga e njëjta parti malli nuk është e nevojshme të analizohen të gjitha vec e vec duke marrë parasysh se cdo fletë analizë pranë Inspektoriatit Sanitar Shtetëror ka një kosto ekonomike. Ndërkohë gjykojmë që është mëse e mjaftueshme që mostra të merret nga secila depozitë dhe të analizohet e gjitha bashkë, pra më një fletë analizë dhe kjo eliminon kostot e panevojshme për të testuar secilën mostër vec e vec! [...],

Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në dokumentet e tenderit, shtojca 5 “Formulari i specifikimeve teknike”, autoriteti ka parashikuar si vijon:

... 5.Dokumentacioni shoqërues i çdo ngarkese të kimikateve të trajtimit të ujit me të cilën do të furnizohet Impianti Bovillë.

Firma furnizuese përpara se të realizojë shkarkimin e kimikateve për çdo ngarkesë të dorëzuar duhet

të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm

1-Certifikatën e origjinës ku jepet origjina e produktit në origjinal.

2-Fletë -analiza e prodhuesit për sasinë e kimikatit të ofruar, në origjinal.

*3-Raport - Analizën të lëshuar nga Inspektoriati Sanitar Shtetëror, në origjinal. **Ne rastin kur transporti do të kryhet me depozita 1000 l atehere duhet që cdo depozitë të jetë shoqëruar me flete-analize.***

III.3.2. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se në rastin konkret pretendimi i operatorit ekonomik nuk lidhet me kriter kualifikues të vendosur nga autoriteti kontraktues, por me mënyrën e ekzekutimit të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se duke qenë se objekti i prokurimit ka një specifikë të veçantë, pasi ka lidhje me trajtimin e ujit të pijshëm për përdorim nga popullata, autoriteti kontraktor me të drejtë në Shtojcën 5, *Specifikimet teknike*, në rubrikën *Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to*, ka parashikuar

edhe kushte e kërkesa për zbatimin, sikurse është kërkesa *që cdo depozite të jete shoqeruar me flete-analize në rastin kur transporti do të kryhet me depozita 1000 l.*

Sa më sipër KPP gjykon, se pretendimi i operatorit ekonomik, për heqjen e kësaj kërkesë gjatë zbatimit të kontratës, është një pretendim i cili nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” SHPK për kriterin “*2.4.Operatori ekonomik duhet të paraqese:*

-Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për mallrat e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit duhet të vertetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Përsa i takon këtij kriteri operatori jonë ekonomik furnizohet nga një distributor i autorizuar i cili nuk lidhur drejt për drejt me prodhuesin por me një distributor tjetër të autorizuar i cili është i lidhur drejt për drejt me prodhuesin, për këtë arsye lidhja është e pamundur dhe për këtë arsye duhet të pranohet vetëm autorizimi i distributorit tonë të autorizuar dhe operatorit tonë ekonomik. Autorizimi jonë tejkalon sasisë e kërkuara nga kjo procedurë prokurimi (gjeni bashkëngjitur).

Për sa më sipër kërkojmë modifikimin e këtij kriteri, duke pranuar ose autorizimin e prodhuesin ose autorizimin e distributorin e autorizuar, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.1. Në dokumentet e tenderit, Shtojca 7, “*Formular i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimi*”, Loti 3 “*Blerje Poliklorur alumini 10±0.5 %*”, pika 2.4 autoriteti kontraktor ka parashikuar:

2.4.Operatori ekonomik duhet të paraqese:

- *Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për mallrat e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor . Në rast se do të paraqitet kjo e fundit duhet të vertetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.*

III.4.2 Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer

shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.4.3. Neni 40, pika 3, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se :

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.4.4. Në lidhje me kërkesën e autoritetit kontraktor për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet në një test proporcionaliteti, së pari, nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur

duhet të vërtetohet se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor harton dokumentet e tenderit, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.4.5. Në rastin konkret KPP gjykon, se kërkesa e autoritetit kontraktor për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit/distributorit të autorizuar, është dokumenti i cili i jep garancinë autoritetit kontraktor për sigurimin e produktit të kërkuar në kohë dhe cilësi dhe përmbushjen me sukses të kontratës. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit KPP konstaton, se autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar në kriteret kualifikuese apo në specifikimet teknike ndonjë kriter tjetër për sigurimin e produktit të kërkuar në kohë dhe cilësi, sikurse mund të ishte paraqitja e katalogut /skedës teknike, ku përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull, ose paraqitja e mostave. KPP vlerëson, se objekti i prokurimit për vetë natyrën e tij ka një impakt social të rëndësishëm, pasi bëhet fjalë për ujin e pijshëm, ndaj edhe garancitë që autoriteti kontraktor synon të përftojë me anë të vendosjes së kriterëve duhet të jenë të një niveli të lartë për të konkluduar me përmbushjen e suksesshme të kontratës objekt - prokurimi.

Për më tepër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se pretendimi i ankimuesit lidhur me këtë kriter, *Për sa i takon këtij kriteri operatori jonë ekonomik furnizohet nga një distributor i autorizuar i cili nuk lidhur drejtpërdrejtë me prodhuesin, por me një distributor tjetër të autorizuar, i cili është i lidhur drejtpërdrejtë me prodhuesin, për këtë arsye lidhja është e pamundur dhe për këtë arsye duhet të pranohet vetëm autorizimi i distributorit tonë të autorizuar dhe operatorit tonë ekonomik, nuk ka të bëjë me pretendim për një kriter në kundërshtim me ligjin, por një pretendim i cili nuk mund të përmbushet nga operatori ekonomik ankimues.* Për sa më sipër, KPP gjykon, se kërkesa e autoritetit kontraktor për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit/distributorit të autorizuar, duke vërtetuar dhe lidhjen mes distributorit dhe prodhuesit, nuk është një kërkesë e ekzagjeruar dhe as në kundërshtim me qëllimin e *lex specialis* dhe rregullat e prokurimit, e për rrjedhojë nuk duhet të modifikohet/hiqet.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” SHPK për kriterin 2.8. *Në rast se operatori ekonomik ofertues nuk është prodhues operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë vetëdeklarim me anë të së cilës duhet të deklarojë se mallrat janë konform normave SSH EN 901;2013)*

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit në sistemin elektronik.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, certifikatën e prodhuesit konform normave, SSH EN 901;2013).

Lidhur me këtë kriter duke theksuar edhe një herë që ne si operator ekonomik kemi lidhje jo me prodhuesin por me një distributor të autorizuar, nuk mund të posedojmë certifikatën e prodhuesit por deklaratën e distributorit që mallrat janë Konform normave SSH EN 901;

2013 (gjeni bashkengjitur autorizimin konform SSH EN 901;2013). Për sa më sipër kërkojmë që dorëzimi i këtij dokumenti nga ana jonë mos të jetë kusht për skualifikim.

Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.5.1.Në dokumentet e tenderit, Shtojca 7, “Formular i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit”, Loti 3 “Blerje Poliklorur alumini $10\pm 0.5\%$ ”, pika 2.8, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

2.8.Në rast se operatori ekonomik ofertues nuk është prodhues operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë vetëdeklarim me anë të së cilës duhet të deklarojë se mallrat janë konform normave SSH EN 17034:2018).

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit në sistemin elektronik.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, çertifikatën e prodhuesit konform normave, SSH EN 17034:2018).

III.5.2.Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës...

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.5.3. Neni 40, pika 3, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se :

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të

përcaktojnë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.5.3. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtë për drejtë me kriterin e vendosur. Referuar kriterit të përcaktuar në pikën 2.8. të dokumenteve të tenderit KPP konstaton, se autoriteti kontraktor në përmbushje të këtij kriteri kualifikimi ka kërkuar fillimisht paraqitjen e një vetëdeklarimi që mallrat janë konform normave SSH EN 17034:2018 dhe paraqitjen e certifikatës së prodhuesit përpara publikimit të njoftimit dhe nisjes së afateve të ankimit. Autoriteti kontraktor e argumenton vendosjen e këtij kriteri me natyrën e veçantë të objektit të prokurimit, pasi bëhet fjalë për ujin e pijshëm dhe *paraqitja e certifikatës që verteton konformitetin e produktit në prokurim me normat SSH EN 17034:2018 Produkte kimike për tretimin e produkteve për trajtimin e ujit të destinuar për konsum njerezor, konform normave të mësipërme, është i rëndësishëm në funksion të verifikimit të përputhshmërisë së mallrave konform normave të mësipërme*. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se një përcaktim i tillë për mënyrën e përmbushjes së këtij kriteri, nuk është në përputhje me dispozitat e LPP dhe akteve nënligjore në fuqi. Neni 26, “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*” pika 6 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht: “*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike*”. Certifikata e prodhuesit e kërkuar nga autoriteti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit, nuk është e parashikuar në dokumentet e përcaktuara në këtë pikë të VKM. Qëllimi në vetvete i LPP-së, është trajtimi i barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në rastin konkret, kriteri i mësipërm i vendos në kushte të pabarabarta ofertuesit, pra nuk është e qartë se si do të konsiderohet i përmbushur kriteri. Sa më sipër KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të rishikojë kriterin e përcaktuar në pikën 2.8. të dokumenteve të tenderit, duke e modifikuar atë sa i përket mënyrës së plotësimit të tij.

Sa i përket pretendimit/kërkesës së operatorit ekonomik ankimues, që dorëzimi i certifikatës së prodhuesit konform normave SSH EN 901:2013, në përmbushje të kriterit 2.8 të dokumenteve të tenderit, të mos jetë kusht për skualifikim, KPP vlerëson, se dorëzimi i certifikatës së prodhuesit nuk është një kërkesë e ekzagjeruar dhe as në kundërshtim me qëllimin e *lex specialis* dhe rregullat e prokurimit, e për rrjedhojë nuk duhet të hiqet.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” SHPK për kriterin **2.10**. Në rast se operatori ekonomik është importues atëherë duhet të paraqesë në sistemin elektronik lejen e importit të lëshuar nga Komisioni i Licensave pranë Ministrisë së Shëndetësisë për llojet e sasisë e kimikateve të përcaktuara në DST. Në rast

se operatori ekonomik është prodhues vendas atëherë duhet të paraqesë në sistemin elektronik leje mjedisore e tipit A të lëshuar nga QKL për të gjitha kimikatet e kërkuara nga AK. Në rast se operatori ekonomik është tregtues vendas atëherë operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik kontratë furnizimi me një prodhues vendas shoqëruar me lejen mjedisore e tipit A të lëshuar nga QKL të prodhuesit vendas ose kontratë furnizimi me 1(një) importues të mallrave si dhe lejen e importit të importuesit të lëshuar nga Komisioni i Licensave pranë Ministrisë së Shendetësisë për llojet e sasisë e kimikateve të përcaktuara në DST. [...] Referuar sa më lart, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e veçantë të kualifikimit, duke e përshtatur atë me dispozitata ligjore në fuqi me qëllim edhe nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe rritjes së konkurrencës, duhet të cilësojë në kriter se leja e importit do të bëhet e kërkueshme në rastin kur ofertuesi shfaqet në cilësinë e importuesit të produkteve të mallit objekt prokurimi.” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.6.1. Në dokumentet e tenderit, Shtojca 7, “Formular i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit”, Loti 3 “Blerje Poliklorur alumini 10 ± 0.5 %”, pika 2.10, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

2.10. Në rast se operatori ekonomik është importues atëherë duhet të paraqesë në sistemin elektronik lejen e importit të lëshuar nga Komisioni i Licensave pranë Ministrisë së Shendetësisë për llojet e sasisë e kimikateve të përcaktuara në DST.

Në rast se operatori ekonomik është prodhues vendas atëherë duhet të paraqesë në sistemin elektronik leje mjedisore e tipit A të lëshuar nga QKL për të gjitha kimikatet e kërkuara nga AK.

Në rast se operatori ekonomik është tregtues vendas atëherë operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik kontratë furnizimi me një prodhues vendas shoqëruar me lejen mjedisore e tipit A të lëshuar nga QKL të prodhuesit vendas ose kontratë furnizimi me 1(një) importues të mallrave si dhe lejen e importit të importuesit të lëshuar nga Komisioni i Licensave pranë Ministrisë së Shendetësisë për llojet e sasisë e kimikateve të përcaktuara në DST.

III.6.2. Në nenin 77, pika 1 dhe pika 4 “Kërkesat për kualifikim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

“Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.6.3. Në nenin 40, pika 3 dhe 4, “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.6.4. KPP gjykon, se në rastin konkret, kriteri lidhet me paraqitjen e lejes së importit të lëshuar nga (Komisioni i Licencave), Ministria e Shëndetësisë për mallrat objekt-prokurimi, në rast se operatori ekonomik është importues ose me paraqitjen e lejes mjedisore të tipit A të lëshuar nga QKL në rast se operatori ekonomik është prodhues vendas, ose me paraqitjen e kontratës së furnizimit me një prodhues vendas, shoqëruar me lejen mjedisore të tipit A të lëshuar nga QKL të prodhuesit vendas, ose me një kontratë furnizimi me një importues të mallrave, si dhe lejen e importit të importuesit të lëshuar nga Komisioni i Licencave pranë Ministrisë së Shëndetësisë, në rast se operatori ekonomik është tregtues vendas. KPP gjykon se me kriterin e vendosur, autoriteti kontraktor i ka dhënë të drejtë të marrin pjesë në procedurën e prokurimit, operatorëve ekonomikë që janë importues të mallrave nga jashtë, operatorëve që janë prodhues, si dhe tregtarëve që e blejnë produktin e importuar në tregun vendas ose e blejnë nga prodhuesi, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në nenin 21 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”. Një fakt i tillë vërtetohet edhe nga argumentet shtesë që OE ankimes, ka paraqitur pranë KPP-së në datën 08.01.2024. Referuar këtyre të fundit, pretendimin lidhur me këtë kriter, OE ankimes e lidh me pamundësinë e tij për të siguruar lejen e importit nga M.SH. Referuar kriterit të kualifikimit, KPP konstaton, se operatorëve ekonomikë iu është dhënë mundësia e plotësimit të këtij kriteri në mënyra të tjera. KPP vlerëson gjithashtu, se nuk ndodhemi në rastin e ngjashëm që operatori ekonomik ankimes pretendon. Referuar sa më lart, KPP gjykon se pretendimi i operatorit ekonomik ankimes që autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e veçantë të kualifikimit, duke e përshtatur atë me dispozitatat ligjore në fuqi me qëllim edhe nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe rritjes së konkurrencës, duhet të cilësojë në kriter se leja e importit do të bëhet e kërkueshme në rastin kur ofertuesi shfaqet në cilësinë e importuesit të produkteve të mallit objekt prokurimi.” është një pretendimi i cili nuk qëndron, pasi kriteri 2.10. i përcaktuar në dokumentet e tenderit është i qartë dhe në përputhje me dispozitatat ligjore në fuqi.

Sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes nuk qëndron.

III.7. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” SHPK për kriterin **2.11**. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik fleten e analizës nga Instituti i Shendetit Publik për analizat si me poshtë: Ngjyra dhe Era, Plumbi(Pb), Kadmiumi (Cd), Kromi (Cr), Nikeli(Ni), Densiteti ose Analizimi i metaleve të renda të kimikateve të behet në një laborator të licensuar (vëndas ose të huaj), Qender Kerkimore (IKV, IFBZ) apo Universitare që ka kapacitete dhe aparatura të analizoje metalet e renda në produkte të ndryshme, përfshire dhe kimikatet e siperpermendura. (Për të gjithë elementet të cilët nuk kryhen nga Instituti i Shendetit Publik)*

Se pari: "Densiteti" i kërkuar tek flete analiza e Institutit të Shendetit Publik, për mallin objekt prokurimi nuk kryet nga Instituti i Shendetit Publik.

Se dyti: Bashkëngjitur gjeni përgjigjet e dy institucioneve të cilët AK ka cituar si laborator vendas (IKV dhe IFBZ) për kryerjen e analizës toksikologjike. Në përgjigjen e tyre drejtuar Operatorit tonë ekonomik, shprehen qartë se ata nuk kryejnë analiza toksikologjike për produktet mall objekt prokurimi. Kërkojme nga AK shkresën ose informacionin mbi të cilin ata janë bazuar për të cituar këto dy insitucione (IKV dhe IFBZ) si laboratorë të licensuar për kryerjen analizave toksikologjike të kërkuara.

A ka AK informacion shkresor që këto 2 insitucione i kryejnë këto analiza? Sepse një AK duhet të ketë informacion të bazuar në shkresa për të përpiluar një kriter të vecantë kualifikimi dhe jo të marrë përsipër të vendosë kritere të pa dokumentuar ose vërtetuar me fakte, sikurse rezulton të ketë vepruar në rastin e këtyre dy institucioneve.

Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.7.1.Në dokumentet e tenderit, Shtojca 7, “Formular i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimi”, Loti 3 “Blerje Poliklorur alumini 10 ± 0.5 %”, pika 2.11 “Kapaciteti teknik”, autoriteti kontraktor ka parashikuar: **2.11** *Operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik fleten e analizës nga Instituti i Shendetit Publik për analizat si me poshtë : Ngjyra dhe Era, Plumbi(Pb), Kadmiumi (Cd),Kromi (Cr), Nikeli(Ni), Densiteti ose*

Analizimi i metaleve të renda të kimikateve të behet në një laborator të licensuar (vendas ose të huaj), Qender Kerkimore (IKV,IFBZ) apo Universitare që ka kapacitete dhe aparatura të analizoje metalet e renda në produkte të ndryshme, përfshire dhe kimikatet e siperpermendura. (Për të gjithë elementet të cilët nuk kryhen nga Instituti i Shendetit Publik).

III.7.2. Në nenin 77, pika 1 dhe pika 4, “Kërkesat për kualifikim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar

kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.7.3. Në nenin 40, pika 3 dhe pika 6, gërma c “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

[...]

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike

III.7.4. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit, si dhe ka detyrë të përcaktojë kriteret dhe specifikime teknike që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret dhe specifikime teknike në lidhje me mallin e kërkuar, por pa përcaktuar kriteret apo specifikime të cilat mund të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në cilësinë e shërbimit, pasi përcaktimet të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë e operatorëve ekonomikë të interesuar. Në rastin konkret, referuar pretendimeve të ankimuesit konstatohet, se ankimuesi kërkon modifikimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.11 të “Kapacitetit teknik”, e më konkretisht të mospërcaktimit të IKV e IFBZ, si laborator për kryerjen e analizave të parametrave të mallit objekt - prokurimi. Në lidhje me kërkesën e autoritetit kontraktor mbi paraqitjen e fletë - analizës nga ISHP për analizat si më poshtë: Ngjyra dhe Era, Plumbi(Pb), Kadmiumi (Cd), Kromi (Cr), Nikeli(Ni), Densiteti ose Analizimi i metaleve të renda të kimikateve të behet në një laborator të licensuar (vëndas ose të huaj), Qender Kerkimore (IKV,IFBZ) apo Universitare që ka kapacitete dhe aparatura të analizoje metalet e renda të produkteve të ndryshme, përfshirë dhe kimikatet e sipërpermendura.(Për të gjithë elementet të cilat nuk kryhen nga Instituti i Shendetit Publik), Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet në një

test proporcionaliteti, së pari, nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. KPP gjykon, se synimi bazë i kërkesës së autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet pjesëmarrëse disponojnë fletë – analizë për parametrat e sipërshënuara për produktin që prokurohet. KPP gjykon, se në përgjigje të testit të mësipërm të proporcionalitetit, kërkesat për disponimin e fletë - analizës si më sipër cituar, i shërbejnë synimit të autoritetit kontraktor dhe nuk shkojnë përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit. Në këtë mënyrë KPP gjykon, se fletë-analiza në fjalë është proporcionale me objektin e prokurimit dhe në përpjesëtim e të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Pas kërkesës së Komisionit të Prokurimit Publik, ISHP me shkresën nr.49/1 prot., datë 24.01.2024, ka informuar KPP se : *Në përgjigje të shkresës suaj Nr. 3181/5 Prot, datë 10.01.2024, ku kërkon informacion lidhur me disa standarde për produktet për trajtimin e ujit të pijshëm, përkatësisht për produktet Poliklorur alumini 10+ 0.5%, hipoklorit natriumi 13-15% dhe acid klorhidrik 30-33%, dhe analizat toksikologjike që kryhen për këto produkte në ISHP, ju bëjmë me dije si vijon:*

A. Në produktin poliklorur alumini në ISHP analizohen këta tregues: kadmium, krom, plumb, nikel. Për analizimin e këtyre elementëve në produktin Poliklorur Alumini, përdoren metoda analitike të bazuara në Standardin S SH EN 1302 "Kimikate që përdoren për trajtimin e ujrave të destinuara për konsum njerëzor - Koagulantët me bazë alumini - Metodat analitike". Ky standard rekomandohet për analizimin e këtij produkti në S SH EN 883:2006 "Kimikate që përdoren për trajtimin e ujrave të destinuara për konsum njerëzor - Polihidroksikloruri i aluminit dhe sulfat polihidroksikloruri i aluminit" si dhe gjithë substancat me emërtesë sinonime me to (Poliklorur alumini, PAC, PACI, klorur bazik alumini, BAC)...". Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se autoriteti kontraktor ka përcaktuar në kërkesën për kualifikim që ofertuesit të paraqesin fletë - analize të lëshuar nga Instituti i Shëndetit Publik për ato parametra që i realizon ky institucion dhe për analizën e parametave që nuk kryhen nga ky i fundit, autoriteti kontraktor ka parashikuar mundësinë që këto analiza të kryhen edhe nga laboratorë të tjerë shtetërorë apo privat të licencuar në Republikën e Shqipërisë dhe ka përcaktuar si të tillë laboratorin e Institutit të Kërkimeve Veterinare (IKV) dhe laboratorin e Institutit të Fizikës Bërthamore të Zbatuar (IFBZ). Nga verifikimi në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit (DPA) nuk rezulton që IKV dhe IBZ të jenë në listën e organeve të akredituara. Në këtë kuadër, nga shqyrtimi i të gjitha fakteve dhe rrethanave në lidhje me këtë procedurë prokurimi, nga përgjigjia e ISHP-së me përmbajtje si më sipër cituar, si dhe nga verifikimi i bërë në faqen zyrtare të DPA, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor duhet ta rishikojë këtë kriter, duke përcaktuar qartë organizmat ose institucionet konkrete private ose shtetërore të akredituara vendase ose të huaja të cilat mund të kryejnë këto lloj analizash toksikologjike. Gjithashtu, në përcaktimin e këtyre organizmave ose institucioneve konkrete private ose shtetërore të akredituara vendase ose të huaja, autoriteti kontraktor duhet të mbështetet dhe në përvojën e viteve të mëparshme lidhur me realizimin e këtyre llojeve analizash. Për sa më sipër KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e sipërpërmendur, duke përcaktuar qartë organizmat ose institucionet konkrete të akredituara që kanë kapacitete për kryerjen e këtyre llojeve analizash toksikologjike.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.8. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes "Albania Distribution Chemicals" SHPK për kriterin **2.13**. Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre të paktën 1 (një) kimist dhe një drejtues mjeti (brenda numrit të kërkuar në pikën 2.12). Për punonjësën "Kimist" operatori ekonomik duhet të paraqesë diplomë, dhe kontratë pune (e vlefshme për të paktën periudhën e parashikuar) Kjo kërkesë në rastin e ofertuesve që nuk janë prodhues por janë tregtues të produktit objekt-prokurimi është i ekzagjeruar, pasi nuk është e lidhur ngushtë me fazën e paraqitjes së ofertës, por fazën e zbatimit të kontratës, prandaj autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e këtij kriteri, duke përcaktuar vetëm mundësinë që operatorët ekonomikë ofertues të kenë mundësinë për të disponuar një punonjës me profesionin kimist sipas formës ligjore të parashikuar në legjislacionin përkatës dhe për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës, si dhe duke hequr kërkesën që ky punonjës të figurojë i punësuar në listëpagesën e shoqërisë.

- Për punonjësën "Drejtues mjeti" dokumentet që duhet të paraqesë janë: Leje drejtimi për mjete që kryejnë transportin e lëndëve të rrezikshme (ADR) (e vlefshme) si dhe të figurojë në listëpagesat e muajit të fundit të shoqërisë. Për rastin kur mjetet dhe makineritë sigurohen nëpërmjet kontratës së qirasë atëherë operatori ekonomik për punonjësën "Drejtues mjeti" duhet të paraqesë kontratë punësimi për vetëdeklarimet mbi punonjësit e kërkuar në DST. (Nëse operatori ekonomik oferton për lote të vecanta, nr. i punonjësve duhet t'i korrespondojë numrit të punonjësve të kërkuar në lotin që oferton, ose shumës së loteve që oferton) Duke qenë se ky kriter lidhet ngushtë me kriterin 2.14, gjëni arsyetimin tek kriteri 2.14. Kërkojmë modifikimin e këtij kriteri.

Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.8.1. Në dokumentet e tenderit, Shtojca 7, "Formular i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit", Loti 3 "Blerje Poliklorur alumini 10 ± 0.5 %", pika 2.13 "Kapaciteti teknik" autoriteti kontraktor ka parashikuar: **2.13**. Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre të paktën 1 (një) kimist dhe një drejtues mjeti (brenda numrit të kërkuar në pikën 2.12).

- Për punonjësën "Kimist" operatori ekonomik duhet të paraqesë diplomë, dhe kontratë pune (e vlefshme për të paktën periudhën e parashikuar)
- Për punonjësën "Drejtues mjeti" dokumentat që duhet të paraqesë janë: Leje drejtimi për mjete që kryejnë transportin e lëndëve të rrezikshme (ADR) (e vlefshme) si dhe të figurojë në listëpagesat e muajit të fundit të shoqërisë.
- Për rastin kur mjetet dhe makineritë sigurohen nëpërmjet kontratës së qirasë atëherë operatori ekonomik për punonjësën "Drejtues mjeti" duhet të paraqesë **kontratë punësimi** për vetëdeklarimet mbi punonjësit e kërkuar në DST.

Shënim: Për pikat 2.12, 2.13 më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.8.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose të kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

III.8.2. Në nenin 77, pika 1, dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Ndërsa në nenin 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, parashikohet se: “Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta. 2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t’i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë. 3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim. 4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Autoriteti ose enti kontraktor duhet t’i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit. 5. Nëse operatori ekonomik shfrytëzon aftësi nga subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e marrëveshjes.”

III.8.3. Në nenin 40 pika 5/b “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshme për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”.

III.8.4. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërehet, se autoriteti kontraktor ndër të tjera ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar në stafin e tij minimalisht 1 (një) kimist, i cili do të jetë i nevojshëm për procesin e kolaudimit dhe marrjes në dorëzim të produktit objekt-prokurimi, ndërkohë që ky person është i nevojshëm për fazën e zbatimit të kontratës, si dhe një drejtues mjeti.

III.8.5. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik, duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit.

Në rastin konkret autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatorët ekonomikë ofertues të kenë të punësuar në stafin e tyre të paktën muajin e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit, 1 (një) punonjës me profesionin kimist, duke e argumentuar këtë kriter me nevojën për prezencën e një kimisti gjatë procesit të dorëzimit dhe kolaudimit të produktit objekt-prokurimi, sipas specifikimeve teknike të parashikuara në Shtojcën 5 të dokumenteve të tenderit. Lidhur me këtë argument të autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kërkesa që ofertuesi të disponojë në stafin e tij 1 (një) punonjës me profesionin kimist, është një kërkesë e parashikuar në dispozitat ligjore të sipërpërmendura dhe njëkohësisht është e lidhur ngushtë me objektin e prokurimit, i cili ka një specifikë të veçantë, pasi ka lidhje me trajtimin e ujit të pijshëm për përdorim nga popullata, ndërsa lidhur me përcaktimin që punonjësi me profesionin kimist të jetë i punësuar në stafin e ofertuesit të paktën muajin e fundit nga data e zhvillimit të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kjo kërkesë në rastin e ofertuesve që nuk janë prodhues por janë tregtues të produktit objekt prokurimi është i ekzagjeruar, pasi kjo kërkesë nuk është e lidhur ngushtë me fazën e paraqitjes së ofertës, por me fazën e zbatimit të kontratës, prandaj autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e këtij kriteri, duke përcaktuar vetëm mundësinë që operatorët

ekonomikë ofertues, të kenë mundësinë për të disponuar një punonjës me profesionin kimist sipas formës ligjore të parashikuar në legjislacionin përkatës dhe për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës, si dhe duke hequr kërkesën që ky punonjës të figurojë i punësuar në listëpagesën e shoqërisë për muajin e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

Po ashtu, autoriteti kontraktor në pikën 2.13 të kriterëve të kualifikimit, ka parashikuar që operatorët ekonomikë ofertues të kenë të punësuar në stafin e tyre 1 (një) drejtues mjeti, duke e argumentuar këtë kriter me specifikën e procedurës së prokurimit, për të cilën është parashikuar përveç furnizimit të mallit objekt – prokurimi, edhe transporti pranë venddorëzimit të tyre në destinacionin përkatës. Sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ankimues për heqjen e këtij kriteri, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se autoriteti kontraktor ka parashikuar dy mënyra për përmbushjen e tij; 1. operatori ekonomik ofertues mund ta ketë në stafin e tij drejtuesin e mjetit ose 2. mund ta disponojë atë me kontratë. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se referuar objektit të prokurimit kërkesa e autoritetit kontraktor për të pasur një drejtues mjeti (i punësuar ose me kontratë) është një kërkesë e nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Akoma më tej, KPP gjykon, se referuar parashikimeve ligjore, operatorët ekonomikë pjesmarrës të mundshëm në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/entet kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështeteten në kapacitetin e subjekteve të tjera sipas parashikimeve të nenit 84 të LPP-së.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

III.9.Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” SHPK për kriterin 2.12. *Një punësim mesatar i të paktën 3 (tre) personave, për muajin e fundit të vërtetuar me;*

- *Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit;*
- *List pagesat e punonjesve sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit.*

(Nëse operatori ekonomik oferton për lote të vecanta, nr.i punonjësve duhet të korrespondojë numrit të punonjësve të kërkuar në lotin që oferton, ose shumes se loteve që oferton

Kriteri për të pasur tre punonjës për të marrë pjesë në një procedurë, 6 nëse merr pjesë në dy procedura dhe 9 nëse merr pjesë në tre, është një kriter i cili nuk lidhet ngushtë me mallin objekt - prokurimi, pasi në rastin e operatorit tonë ekonomik, ne jemi tregtues i mallit objekt prokurimi, madje në rastin konkret ne nuk do të bëjmë as transportin e mallit (pasi atë do të na e sigurojë vetë furnitori) dhe as magazinimin e mallit pasi furnitori jonë merr përsipër transportin e mallit në pikat e magazinimit të përcaktuar nga AK sipas grafikut të lëvrimit që do të vendoset nga vetë AK.

Për sa më sipër, kriteri që përcakton numrin e punonjësve që duhet të ketë OE është i panevojshëm dhe nuk ka asnjë efekt në ecurinë e procedurës së prokurimit në asnjë fazë të saj,

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se referuar arsyetimit të bërë në pikën III.8. të këtij vendimi, lidhur me pretendimin e ankimuesit për stafin e operatorit ekonomik ofertues, kriteri 2.12, për përcaktimin e një punësimi mesatar të të paktën prej 3 personave për muajin e fundit,

nuk është në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës, e për rrjedhojë autoriteti kontraktor duhet ta modifikojë atë.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

III.10. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” SHPK për kriterin 2.14 *Operatori ekonomik për Loti 1 “Blerje Hipoklorit Natriumi 13-15%”, duhet të ketë në pronësi ose me qira 2 mjete (autobot) të autorizuar për transport kimikatesh. Gjithashtu, për transportin e këtyre kimikateve mund të perdoren depozita 1000 l IBC (intermedite bulk container) të jete të vulosura, të pajisura me certifikatat e testimi dhe certifikatat ADR për secilen depozitë, dhe të miratura në përputhje me dispozitat ADR sipas ligjit Nr. 118/2012 „PËR TRANSPORTIN E MALLRAVE TË RREZIKSHME” për arsye se këto kimikate klasifikohen si produkt ADR me kodet si më poshtë.*

Kodi UN1791, ADR 1791 solucion HIPOKLORIT NATRIUMI

Kamioni që transporton kimikatet me këto depozita 1000 l duhet gjithashtu të jete i pajisur me certifikate (ADR) për transport lëndesh të rrezikshme (KIMIKATE).

Nëse operatori ekonomik oferton për më shumë se një lot, duhet të vetëdeklarojë, se disponon mjete transporti për secilin nga kimikatet që do të transportojë, sipas specifikimeve teknike të kërkuara për këtë procedurë prokurimi.

Së pari: *Për sa i takon kriterit 2.14 në lidhje me të paturin në pronësi ose me qira të një autoboti ose automjeti, operatori jonë ekonomik nuk ka në pronësi dhe as me qira një autobot ose automjet, pasi furnitori jonë na siguron transportin e mallrave objekt - prokurimi me autobot ose automjetet e transportuesit të tij dhe në nuk e kemi të nevojshme të kemi në pronësi ose me qira autobot ose automjet (gjeni bashkelidhur deklaratën doganore në të cilën shihet qartë në pikën 12 Detajet e vlerës dhe pikën 20 Kushtet e lëvrimit, CPT, Tiranë AL që transporti sigurohet nga furnitori, ndërsa në pikën 18 dhe 21 dallohen targat e autobotit. Po kështu furnitori jonë merr përsipër të sjellë mallrat objekt - prokurimi sipas vendndodhjeve të përcaktuara në Shtojcën 5.*

...Për këto arsye kërkojmë që këto kritere të hiqen ose të modifikohen, duke përfshirë edhe situacionin e operatorit tonë ekonomik”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.10.1. Në dokumentet e tenderit, Shtojca 7, “Formular i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimi”, Loti 3 “Blerje Poliklorur alumini 10±0.5 %”, pika 2.14, autoriteti kontraktor ka parashikuar: 2.14. *Operatori ekonomik për Loti 3 “Blerje Poliklorur alumini 10±0.5 %, duhet të ketë në pronësi ose me qira 1 mjet (autobot) të autorizuar për transport kimikatesh Gjithashtu për transportin e këtyre kimikateve mund të perdoren depozita 1000 l IBC (intermedite bulk container) të jete të vulosura, të pajisura me certifikatat e testimi dhe certifikatat ADR për secilen depozitë, dhe të miratura në përputhje me dispozitat ADR sipas ligjit Nr. 118/2012 „PËR TRANSPORTIN E MALLRAVE TË RREZIKSHME” për arsye se këto kimikate klasifikohen si produkt ADR me kodet si më poshtë*

Kodi ADR 3264 solucion POLIKLORUR ALUMINI

Kamioni që transporton kimikatet me këto depozita 1000 l duhet gjithashtu të jete i pajisur me certifikate (ADR) për transport lëndesh të rrezikshme (KIMIKATE).

Nëse operatori ekonomik oferton për më shumë se një lot, duhet të vetëdeklarojë, se disponon mjete transporti për secilin nga kimikatet që do të transportojë, sipas specifikimeve teknike të kërkuara për këtë procedurë prokurimi.

Për të vërtetuar disponimin e mjeteve të kërkuara më lart operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi) për “Transport lende te rrezikshme”, lejen e qarkullimit, plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme) dhe për mjetet e siguruara me qira, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme), duhet të shoqerohet me kontratën përkatëse të qirase/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentet që vërtetojnë pronësinë e tyre.

c) Për mjetet e marra me qira të paraqitet kontrata përkatëse e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për mjetet e deklaruar ku të jenë të dukshme dhe targat e mjetit.

e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë në sistemin elektronik se disponon mjete për të realizuar kontratën objekt - prokurimi.

Shënim: Për pikat 2.14 më sipër operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.8.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose t'i kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

III.10.2. Neni 2, Qëllimi i ligjit 162/2020 Për Prokurimin Publik, parashikon shprehimisht se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Neni 3, Parime të përgjithshme 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin

mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.10.3. Neni 21, Autoriteti ose enti kontraktor 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.10.4. Neni 77, “Kërkesat për kualifikim” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikon se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e 48 duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.10.5. Në pikat 4 dhe 6 të nenit 39 “Kërkesat e cilësisë”, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: “4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.10.6. Në nenin 84, “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” i ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, parashikohet se: “Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta. 2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e

kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t'i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë. 3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim. 4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit. 5. Nëse operatori ekonomik shfrytëzon aftësi nga subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e marrëveshjes.”

III.10.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në lidhje me pretendimin e ankimuesit për heqjen e disponimit në një nga format e parashikuara nga ligji (pronësi apo qira) të mjetit të autorizuar për transport kimikatesh, pasi furnitori i siguron transportin e mallrave objekt - prokurimi me autobot ose automjetet e transportuesit të tij, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se referuar objektit të prokurimit, që në rastin konkret është kontratë malli, për të cilin është e nevojshme vënia në dispozicion e ofertuesit fitues që do të transportojë këto mallra, që të ketë në posedim (në pronësi ose me qira), një mjet të autorizuar për transportin e mallrave që do të prokurohen për t'u dërguar në destinacionin e kërkuar sipas AK, gjykon se kërkesa e përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi disponimin e 1 mjeti, është një kërkesë e nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Akoma më tej, KPP gjykon, se referuar parashikimeve ligjore, operatorët ekonomikë pjesmarrës të mundshëm në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/entet kontraktore në dokumentet e tenderit, mund të mbështeteten në kapacitetin e subjekteve të tjera sipas parashikimeve të nenit 84 të LPP-së.

Sa më sipër, pretendimi i ankimuesit “Albania Distribution Chemicals” SHPK nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, për procedurën e prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-91613-12-19-2023, me objekt: “Blerje Kimikate për nevojat e Ukt.Sh.A”, me fond limit 209,959,375 lekë pa TVSH, me Nr. REF-91621-12-19-2023, me objekt: “Loti 3: ‘Blerje Poliklorur Alumini $10\pm 0.5\%$ ’”, me fond limit 76,560,000 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 22.01.2024, nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujësjiellës Kanalizime Tiranë.
2. Të pranoje pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri

